



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 38/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së tubimit publik para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale në komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 13.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më 11.04.2012, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, më të cilën pretendohet se LVV ka organizuar dhe mbajtur tubim publik me datën 06.04.2012 në ora 19:00 në shkollën fillore “Muharrem Shemsedini” në fshatin Bibaj, ku me ç’rast ka thyer Rregullën Zgjedhore nr. 13/2009, Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, duke mbajtur tubim publik me përmbajtje garuese për zgjedhjet e lokale në Komunën e Ferizajt, para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës propozon që të shqiptohen masa ndëshkimore ligjore ndaj subjektit politik në fjalë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë materiale ftesën e LVV për mbajtjen e tubimit publik.

KREU -VII- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)

Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike

Neni 44 i LZP-së, përcakton aktivitet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe mënyrat e specifikuar me atë dispozitë.

Në dispozitën e nenit 33 të LZP-së dhe Rregullorja Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitat e

lartë cekura ju ndalohen veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Meqenëse veprimet e pretenduara nga parashtruesi i ankesës janë bërë para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale në Komunën e Ferizajt, PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore konstatoi se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së nuk është paraparë marrja e masave ndëshkimore siç pretendohet, për mbajtjen e tubimeve apo fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 38/2012 më datën 13.04.2012.

